

Gjethpërdredhësja e pjeshkës (*Taphrina deformans* .(berk). Tul)

Është ndër sëmundjet kryesore e kulturave bërthamore. Prek kryesisht pjeshkën por edhe bajamen. Gjëndet e përhapur kudo ku kultivohen këto kultura. Në vitet me mot të freskët dhe me lagështi të mjaftushme shkakton dëme që arrijnë deri në 80% të prodhimit. Kjo sëmundje e ka origjinën nga Kina. Për herë të parë në kontinentin Europian është konstatuar në Angli në vitin 1821 e më vonë është përhapur edhe në vënde të tjera.

Shënjat e sëmundjes mund të shfaqen në të gjitha pjesët e gjelbërta të bimës, si në gjethë, lastarë , lule por edhe në fruta. Simptomat karakteristike shfaqen në gjethë në formë të fryrjes, trashjes së indit e përdredhjes totale të saj. Gjethja e infektuar në fillim ka ngjyrë të kuqërremtë te purpurtë, ndërsa më vonë kalon në nuancë të verdhë. Përdredhja fillon në stadin e celjes së sythave, me një lokalizim në mes të gjethes që më vonë zgjerohet dhe përfshin një pjesë të madhe të indit, me hipertrofi të theksuar dhe pa klorofil. Gjethet e fryra zverdhen dhe shumë shpejt bien në tokë.



Sëmundja ndikon drejtpërdrejt në rënien e prodhimit, sepse pema e infektuar rëndë mbetet shpejt pa gjethë dhe gradualisht pa fruta.

Infeksionet nuk vazhdojnë gjatë vegjetacionit, por gjendja totale e pemës është e dobët, sepse shpenzon lëndë ushqyese rezervë, duke formuar një numër shumë të vogël sythash frutorë për vitin e ardhshëm. Bima e xhveshur nga gjethet në muajin Qershor fillon të nxjerrë gjethë të reja, duke harxhuar gjithë rezervën e saj ushqimore.

Shënjat e sëmundjes në fruta janë më të rralla, ndërsa në lastarë shfaqen fryrje, shkurtime të ndërnjjeve ,ndërsa lulet deformohen dhe bien në tokë. Bimët e dëmtuara janë më të ndjeshme ndaj ngricave të dimrit dhe patogjenëve të tjerë . Në rastet e prekjeve të rënda, rrezikohet ekzistenca e vet pemës.

Konidet me membranë të trashë ose të hollë të patogjenit të cilat formohen nga bulëzimi i askosporeve mbijnë drejtpërdrejt në hife infektuese . Pas zhvillimit të micelit bërthamat ndahen

në qeliza dybërthamore të micelit proces i cili shkakton fryrjen dhe deformimin e gjetheve të pjeshkes.

Sëmundja dimëron në sythat e pemës me askosporet dhe konidet me membranë të trashë. Në pranverë këto organe që përhapen me anën e erës ose të shiut, mbijnë dhe shkaktojnë infektimet e reja në gjethet e pemës. Kërpudha depërton përmes kutikulës ose stomave të gjetheve. Me futjen e micelit në indin e gjethes ose organeve të tjera të pjeshkës, zhvillohet miceli dybërthamor i cili stimulon ndarjen e shpejtuar të qelizave, duke shkaktur frurje dhe deformim të vet gjethes. Duke qënë se kërpudha preferon vetëm indet e rinj, periudha e infektimit është e shkurtër, vetëm në fazat e parë të vegetacionit. Si rezultat i rritjes së qëndrueshmërisë së indeve bimore, nuk ndodhin infektimet dytësorë të pjeshkës. Temperatura optimale e zhvillimit të sëmundjes është 15°C, ndërkohë që ajo mund të zhvillohet në interval të gjërë temperaturash që shkojnë nga 7-28°C.

Masat e kontrollit.

Për kontrollin e sukseshëm të gjethpërdredhjes së pjeshkës ndërmeren masa mbrojtëse në periudha të caktuara. Normalisht për të kontrolluar mirë këtë sëmundje duhen parashikuar që të kryhen jo më pak se dy trajtime kimike. Ndërsa në rastet kur konstatohen prekje të rënda duhen marrë masa që të aplikohen edhe trajtime të tjera gjatë lulëzimit ose gjatë rënies së petëlave. Trajtimi i parë i pemtoreve të mbjellë me pjeshkë aplikohet qysh në vjeshtë, pas rënies së gjetheve me synim reduktimin e potencialit infektues të sporeve të pranishme duke përdorur preparat Triskabol 75EG (Ziram) me dozën 0.4%.

Trajtimi i dytë bëhet në muajin Janar me leng bordolez 3% menjëherë pas krasitjes.

Trajtimi i tretë bëhet në momentin e fryrjes së sythave duke përdorur preparatin Dodenë (Sullit 65 EG) me dozën 0.08-0.12%.

Në rastet kur kemi infeksione të rënda rekomandohet që të bëhet një trajtim gjatë ose pas lulëzimit duke përdorur preparat Difcor 250 EC me dozën 0.02-0.03%.



Specialisti i mbrojtjes së bimëve

Agr. Mendim Baçaj